

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7135
E enjte, 7 mars 2024
Çmimi 0.50 €


KMDLNj-ja: Standardet e dyfishta të drejtësisë ndaj gazetarit Lirim Mehmetaj



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



SIPAS RAPORTIT TË KOMF-it, FËMIJËT NË KOSOVË PËRBALLEN ME SHUMË PROBLEME E ME PAK ZGJIDHJE



Dhuna, trafikimi, punët e rënda dhe mungesa e psikologëve, janë disa nga problemet me të cilat përballen fëmijët në Kosovë, sipas një raporti të Koalicionit të Organizatave Joqeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF). Raporti ka bërë analizimin e përparimit për politikën, legjislacionin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në gjashtë fusha: mirëqenia sociale, mbrojtja e fëmijës, shëndeti i fëmijës, zhvillimi në fëmijërinë e hershme, arsimit dhe drejtësia për të mitur

AKTUALE




BIDENI DHE TRUMPI DOMINOJNË NË GARAT E "SUPER TË MARTËS" F. 2

ZBULOHEN BUSTET E HERONJVE SALA DHE HAMIT JASHARI F. 3

EMËROHET RAPORTUESI PËR HEQJEN E VIZAVE PËR POSEDUESIT E PASAPORTAVE SERBE NË KOSOVË F. 6

JAVA E KATËRT E GREVËS SË PUNËTORËVE TEKNIKË TË UP-së F. 5

EKONOMI



Ç'ËSHËTË AKTI I BE-SË PËR TREGJET DIGJITALE DHE SI I SFIDON GJIGANTËT TEKNOLOGJIKË? F. 8

MFPT SHPALL ANKANDIN E TRETË TË LETRAVE ME VLERË F. 8

SPORT



PRISHTINA DHE DRITA KUALIFIKOHEN NË GJYSMËFINALE TË KUPËS F. 10

LIDERËT E SHTETIT DHE ATË TË OPOZITËS BËJNË HOMAZHE NË PREKAZ F. 7



KRYEMINISTRI I MAQEDONISË SË VERIUT VIZITON KOLEGJIN AAB, MBAN LIGJËRATË PËR MARRËDHËNIET MIQËSORE KOSOVË - MAQEDONI F. 5



RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni dhe Trumpi dominojnë në garat e “Super së Martës”

WASHINGTON, 6 MARS - Presidenti amerikan Joe Biden dhe paraardhësi i tij, Donald Trump, çimentuan një përballje të re në zgjedhjet presidenciale të nëntorit dhe gjatë “Super së Martës” u rrit edhe presioni ndaj rivales së Trumpit, Nikki Haley, që të lë garën në mesin e republikanëve.

Bideni dhe Trumpi fituan në Kaliforni, Teksas, Alabama, Kolorado, Mejn, Oklahoma, Virxhinia, Karolinë të Veriut, Tenesi, Arkansas, Minesota dhe Masaçusets. Bideni, po ashtu, fitoi garën në mesin e demokratëve edhe në Utah, Vermont dhe Ajova.

Haley fitoi në Vermont, duke ia mohuar Trumpit një fitore të plotë, por ish-presidenti fitoi në shtetet e tjera që mund të mos kenë qenë shumë favorite për të, sikurse Virxhinia, Masaçusets dhe Mejn, shtete



që kanë numër të madh të votuesve të moderuar, që e kishin mbështetur Haleyn në zgjedhjet e mëparshme paraprake.

Gjatë këtij muaji pritet të votojnë shtetet e tjera, që Bideni dhe Trumpi zyrtarisht ta marrin nominimin e partive të tyre për të garuar në zgjedhjet presidenciale. Por, gjatë “Super së Martës”, që është dita më e

rëndësishme e zgjedhjeve paraprake, u bë e qartë se një përballje e sërishme Biden - Trump është pothuajse të sigurt. Sikurse Bideni, 81 vjeç, ashtu edhe Trumpi, 77 vjeç, vazhdojnë të dominojnë në partitë e tyre pavarësisht se përballen me pyetje që kanë të bëjnë me moshën dhe me asnjërin që nuk kanë popullaritet të gjerë për zgjedhjet e përgjithshme.

Të vetmen garë që Bideni e humbi të martën ishte në Samoan Amerikane, që është një territor i vogël i ShBA-së në Oqeanin Paqësor. Ai u mposht nga kandidati Jason Palmer, që fitoi 51 vota, kundrejt 40 votave që i fitoi presidenti amerikan.

Haley ndoqi rezultatet zgjedhore të “Super së Martës” larg syrit të publikut.

Zyrtarë nga fushata e saj thanë përmes një deklarate se rezultati reflektoi atë se kishte shumë republikanë “që po shprehin shqetësime të thella për Donald Trumpin”.

Më vonë u njoftua se Haley do të njoftojë të mërkurën për largimin nga gara, duke bërë që Trumpi të mbetet kandidati i vetëm nga republikanët.

Ndërkaq, në pronën e Trumpit në Mar-a-Lago kishte shumë njerëz që shkuan në ndejën e fitores. “Për një arsye e quajne ‘Super të Martë’”, u tha Trumpi

të pranishmëve. Më pas ai sulmoi Bidenin lidhur me kufirin ShBA - Meksikë dhe për tërheqjen e ShBA-së nga Afganistani.

Bideni nuk mbajti fjalim, por lëshoi një deklaratë, duke paralajmëruar se rezultatet e së martës i kanë lënë amerikanët me një zgjidhje të qartë dhe duke vënë në pah arritjet e tij pasi mposhti Trumpin në zgjedhjet e vitit 2020. “Nëse Donald Trumpi kthehet në Shtëpinë e Bardhë, i gjithë ky përparim do të jetë në rrezik. Ai nxitet nga ankesat dhe hidhërimi, i përqendruar në hakmarrjen e tij e jo te populli amerikan”, tha Bideni.

Pavarësisht prej dominimit të Bidenit dhe Trumpit në partitë e tyre, sondazhet e kanë bërë të qartë se elektorati i gjerë nuk dëshiron që zgjedhjet e sivjetme të përgjithshme të jenë të njëta me garën e vitit 2020.

Yulia Navalnaya bën thirrje për protestë kundër Putinit

MOSKË, 6 MARS - E veja e liderit opozitar rus Aleksei Navalny u ka bërë thirrje rusëve të protestojnë në ditën e zgjedhjeve kundër presidentit Vladimir Putin, duke formuar radhë të gjata jashtë qendrave të votimit.

Yulia Navalnaya është zotuar se do ta vazhdojë punën e burrit të saj dhe ta vazhdojë kundërshtimin ndaj Kremlinit pas vdekjes së Navalnyt muajin e kaluar në një burg në Arktik.

Përmes një videoje të publikuar në YouTube, Navalnaya mbështeti nismën që të mbingarkohen qendrat e votimit që mbahen gjatë këtij muaji, zgjedhje të cilat pritet t'i japin

edhe një mandat gjashtëvjeçar presidencial Putinit. “Ne duhet të shkojmë në qendrat e votimit në të njëjtën kohë: më 17 mars në orën 12:00. Çfarë do të bëjmë më pas? Ju mund të zgjidhni. Mund të votoni çdo kandidat përveç Putinit. Mund ta bëni të pavlefshëm fletëvotimin tuaj. Mund të shkruani me shkronja të mëdha ‘Navalny’”, tha Yulia Navalnaya.

Ajo i cilësoi zgjedhjet presidenciale, që do të mbahen nga 15 deri më 17 mars, si “farsë” dhe tha se Putini “do ta nxjerrë rezultatit që ai do”.

Sa ishte gjallë dhe gjendej në burg, Aleksei Navalny kishte mbështetur këtë nismë.

Navalnaya, ndërkaq, i ka quajtur “trimat dhe njerëzit më të sinqertë në shtetin tonë”, të gjithë personat që kanë vizituar varrin e bashkëshortit të saj në Moskë.

Kremlini ka kërcënuar personat që bëjnë homazhe për Navalnyn se do t'i arrestojë, duke u thirrur në ligjet e ashpra ruse kundër protestave.

Qindra persona janë arrestuar gjatë homazheve të bëra në mbarë Rusinë.

Sipas Organizatës për të Drejtat e Njeriut, OVD-Info, pesë persona janë arrestuar në Moskë për shkak të pjesëmarrjes në varrimin e Navalnyt apo që e kanë vizituar varrin e tij.



Egjipti: S'ka përparim në bisedimet për armëpushim në Gazë



GAZA, 6 MARS - Tri ditë negociata me Hamasin - grupin palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian për një armëpushim në Gazë dhe lirim të pengjeve izraelite - dështuan që të arrinin përparim të martën në orët e vona, thanë zyrtarët egjiptianë.

Ky njoftim u bë më pak se një javë para nisjes së muajit të Ramazanit, që ishte një afat jozyrtar për arritjen e një marrëveshjeje.

Pothuajse pesë muaj luftime e kanë lënë në gërmadha Gazën dhe kanë krijuar një katastrofë humanitare, teksa banorët e enklavës, veçmas në veri të territorit, po përballen me mungesë të theksuar të furnizimeve ushqimore. “Ne duhet të dërgojmë më shumë ndihmë në Gazë”, tha presidenti amerikan Joe Biden të martën. “Nuk ka më arsytim. Asnjë”, shtoi ai.

Grupet e ndihmës kanë thënë se është bërë pothuajse e pamundur dërgimi i furnizimeve në pjesën

më të madhe të Gazës për shkak të vështirësive në koordinimin me ushtrinë izraelite, armiqësive që po vazhdojnë dhe për shkak të thyerjes së rendit publik.

Shtetet e Bashkuara, Katari dhe Egjipti për javë të tëra kanë tentuar të ndërmjetësojnë një marrëveshje, sipas së cilës, Hamasi do të lironte deri në 40 pengje në këmbim të një armëpushimi gjashtëjavor, do të liroheshin disa të burgosur palestinezë dhe do të rritej ndihma në territorin e izoluar.

Liderët e shtetit dhe ata të opozitës bëjnë homazhe në Prekaz

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 6 mars - Kryeministri Albin Kurti, bashkë me presidenten e vendit, Vjosa Osmani, kryetarin e Kuvendi, Glauk Konjufca dhe anëtarë të kabinetit qeveritar, kanë bërë homazhe të mërkurën në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, në vazhden e aktiviteteve për nder të 26-vjetorit të "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës".

Kryeministri Kurti ka thënë se në

Prekazin heroik dhe historik kthehem dhe rikthehem, që të kujtojmë dhe përkujtojmë çmimin dhe rrënjët e lirisë të cilën e gëzojmë. "Të gjithë dhe secili duhet të vijë në këtë vend, që të mos harrojmë dhe që të mos devijojmë. Që të mos e harrojmë të kaluarën dhe që të mos devijojmë drejt së ardhmes", ka thënë ai.

Duke çmuar lart sakrificën, vetëfljimin e vetëmohimin e Jasharëve, kryeministri Kurti tha se "Epopëja e Ushtrisë Çlirimtare" është në themelet e çlirimit të



vendit tonë dhe se ajo paraqet edhe dhembje e krenari, por edhe besë dhe shpresë për shtetin dhe popullin tonë.

Pas homazheve, kryeministri Kurti së bashku me presidenten Osmani-Sadriu, kryeparlamentarin Konjufca dhe ministrat të kabinetit qeveritar vizituan familjen Jashari, ku u pritën nga Rifat Jashari.

Edhe lideri i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, së bashku me bashkëpartiakë, ka bërë homazhe në Prekaz. "Në madhështinë solemne të përjetësisë, heroizmi i familjes Jashari rrëfen sakrificat që mishërojnë shpirtin e paepur të lirisë, i cili përgjithmonë do ta ruajë tokën tonë të shenjtë!", ka thënë Krasniqi.

Homazhe në Prekaz ka bërë edhe kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, i cili ka thënë se guximi i Adem Jasharit dhe familjes së tij për të vdekur u bë mundësia jonë për të jetuar. "Pushkët e Prekazit ishin krismat e lirisë, ishin thirrje për mobilizim dhe rezistencë. Prekazi u bë vendi ku u ndanë epokat, aty rruga u bë e pakthim", ka thënë Molliqaj.

Zbulohen bustet e heronjve Sala dhe Hamit Jashari



PREKAZ, 6 MARS - Në Prekaz është bërë zbulimi i busteve të heronjve Sala e Hamit Jashari. Aty ishin të pranishëm lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, ai i AAK-së, Ramush Haradinaj dhe i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, nënkryetari i komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku dhe kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci.

Haradinaj ka theksuar se në Prekazin heroik çdo shtëpi ka një histori. "Shembulli i qëndresës heroike të bacës Shaban, Ademit e Hamit e Sala Jasharit ishte shndërruar në strehë të sigurt për celulat e para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Luftëtarët e lirisë gjetën aty ngrohtësinë, por edhe frymëzimin për ta vazhduar rrugën

e lavdisë", ka deklaruar lideri i AAK-së.

Ndërkaq Limaj ka thënë se Tringa e Prekazit, nëna Salë e baca Hamit, janë figurat e rralla të kombit tonë. "Janë dëshmia më e mirë që prindërit tanë ishin edhe bashkëluftëtarët tanë e që në rrethanat më të vështira unë kam pasur fatin dhe nderin që të ha bukën e nënës Salë e të qëndroj në kullën e bacës Hamit. Në Prekazin e lavdisë e në marsin historik u bë zbulimi i busteve të heronjve, Sala e Hamit Jashari, dy prindërve që luftuan për liri e atdhe, e për të cilët sot e gjithnjë do të jenë krenarë djemtë e tyre, gjeneralët Jashari, Sahit dhe Musa Jashari, e bashkë me ta edhe të gjithë ne. Lavdi jetës dhe veprës së nënës Salë e bacës Hamit!", ka thënë Limaj.

Kryetari i Himarës, Beleri, dënohet me dy vjet burgim për blerje votash

HIMARË, 6 MARS - Gjykata e Posaçme e Shqipërisë e ka dënuar me dy vjet burgim kryetarin e zgjedhur të Himarës, Fredi Beleri, pasi e shpalli fajtor për blerje votash në zgjedhjet e vitit 2023.

Beleri, nga pakica greke, u arrestua më 12 maj të vitit 2023, dy ditë para se të mbahej votimi në zgjedhjet vendore për kryetarët e bashkive dhe këshillat bashkiake në Shqipëri.

Policia në atë kohë deklaroi se Beleri dhe tre bashkëpunëtorë të tij u arrestuan nën dyshimet se u kishin ofruar të holla personave të ndryshëm për të blerë vota.

Greqia i kishte bërë thirrje Shqipërisë ta ndalte procesin gjyqësor kundër Belerit, duke thënë se ai mund të ndikonte në rrugën e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkim Evropian.

Por, kryeministri Edi Rama kishte theksuar se kjo ishte çështje e drejtësisë dhe jo e politikës.

Beleri i fitoi zgjedhjet, por nuk ka mundur të betohej si kryebashkiak derisa ndodhej në paraburgim, pasi gjykata nuk e kishte pranuar kërkesën e tij.

Pas vendimit të shkallës së parë, Beleri ka drejtë që brenda 15 ditësh të ankohet në



Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Prokuroria e Posaçme kishte kërkuar për Belerin dy vjet e gjashtë muaj burg. Ashtu si në

çdo seancë, edhe gjatë vendimit, procesi u ndoq nga përfaqësues të ambasadës greke, por dhe të medias greke dhe mbështetësve të tij.

Gjithashtu, në seancë ishte i pranishëm edhe Vangjel Dule, kreu i Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, parti që përfaqëson minoritetin grek në Shqipëri.

Avokati i Fredi Belerit tha për mediet se vendimi ishte politik dhe se gjykata "veproi siç u porosit" nga kryeministri Edi Rama.

Çështja Beleri ka qenë në qendër të debatit në distancë në mes të Shqipërisë dhe Greqisë.



Sipas raportit të KOMF-it, fëmijët në Kosovë përballen me shumë probleme e me pak zgjidhje

Dhuna, trafikimi, punët e rënda dhe mungesa e psikologëve, janë disa nga problemet me të cilat përballen fëmijët në Kosovë, sipas një raporti të Koalicionit të Organizatave Joqeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF). Raporti ka bërë analizimin e përparimit për politikën, legjislacionin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në gjashtë fusha: mirëqenia sociale, mbrojtja e fëmijës, shëndeti i fëmijës, zhvillimi në fëmijërinë e hershme, arsimi dhe drejtësia për të mitur

PRISHTINË, 6 MARS - Dhuna, trafikimi, punët e rënda dhe mungesa e psikologëve, janë disa nga problemet me të cilat përballen fëmijët në Kosovë, sipas një raporti të Koalicionit të Organizatave Joqeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF).

Në raportin e monitorimit "Karta e vlerësimit - cili është rezultati i përgjithshëm i Kosovës për kujdesin ndaj fëmijëve?", të publikuar të mërkurën, KOMF vlerëson se institucionet e Kosovës po bëjnë pak punë për zgjidhjen e problemeve dhe për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve pavarësisht prej zotimeve.

Raporti ka bërë analizimin e përparimit për politikën, legjislacionin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në gjashtë fusha: mirëqenia sociale, mbrojtja e fëmijës, shëndeti i fëmijës, zhvillimi në fëmijërinë e hershme, arsimi dhe drejtësia për të mitur.

"Shtesat për fëmije, zgjidhje e pamjaftueshme"

Sipas këtij raporti, Kosova vazhdon të ketë shkallë të lartë të fëmijëve që jetojnë në varfëri dhe nivele të

larta të përjashtimit social të fëmijëve.

Raporti citon të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, të cilat tregojnë se 7 për qind e fëmijëve në Kosovë jetojnë në varfëri ekstreme.

Qeveria e Kosovës nga viti 2021i ndan nga 10 euro për fëmijët nën moshën 16 vjeçe dhe nga 20 euro për fëmijët deri në dy vjeç. Por, sipas KOMF-it, këto shtesa janë të pamjaftueshme dhe "nuk kanë bazë ligjore të qëndrueshme". "Është shumë i domosdoshëm hartimi i bazës ligjore për shtesat për fëmijë për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre. Shuma mujore e ndarë është e ulët, nuk është e mjaftueshme për t'i përballuar nevojat e fëmijëve", thuhet në raport.

KOMF-i, në raport, gjithashtu, ka vlerësuar se Ligji për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme është diskriminues, ani pse në Kosovë është e përcaktuar e drejta për ndihmë materiale për fëmijët me aftësi të kufizuara si element i mbrojtjes për këtë kategori. "Ky ligj ofron mbështetje për vetëm rreth 3 000 fëmijë me aftësi të kufizuara, duke

përjashtuar pjesën dërrmuese të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Prandaj, si i tillë, ai bën diskriminim dhe nuk mbulon të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara", thuhet në raport. Raporti ka gjetur se mbështetja financiare prej 100 eurosh që u ofrohet fëmijëve dhe familjeve të tyre është e pamjaftueshme për nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Fëmijët, viktimat të trafikimit dhe punëve të rënda

KOMF në raport ka identifikuar se problem mbetet edhe mbrojtja e fëmijëve nga punët e rënda, ku vetëm gjatë vitit 2022 gjithsej 160 fëmijë janë identifikuar në puna të rënda, kryesisht në sektorët sikurse: sektori i bujqësisë dhe pylltarisë, sektori i ndërtimit dhe puna në rrugë.

Fëmijët në Kosovë janë edhe viktimat të trafikimit. Vetëm gjatë vitit 2022 janë identifikuar gjithsej 22 viktimat të trafikimit, prej tyre 14 viktimat ishin fëmijë, sipas KOMF-it. Në raport, gjithashtu, është vlerësuar se ndër sfidat më të mëdha mbetet identifikimi i

fëmijëve viktimat të trafikimit. "Është i domosdoshëm fuqizimi i mekanizmave për identifikim dhe raportim që do të lehtësonte vetëraportimin, raportimin e bashkëmoshatarëve dhe qasjen në raportim të profesionistëve të cilët vazhdimisht punojnë me fëmijët dhe të rinjtë (p.sh. mësimdhënësit, psikologët e shkollave, këshilluesit)", thuhet në raport.

Sipas raportit, sfida është edhe vonesa në zgjidhjen e statusit të 579 fëmijëve pa kujdes prindëror dhe, për pasojë, mosdhënia e mundësisë për adoptim për këta fëmijë. Në Kosovë në vitin 2022 janë shqyrtuar 11 kërkesa për adoptim, prej tyre 9 kërkesa për adoptim vendor janë aprovuar dhe dy kërkesa për adoptim ndërshtetëror (kërkesa brenda familjes) janë refuzuar.

Cilat janë problemet në shëndetësi?

Mungesë e barnave në kujdesin parësor, sekondar dhe terciar shëndetësor, mungesë e shërbimeve parandaluese dhe shërbimeve rehabilituese të specializuara për trajtimin e fëmijëve përdorues të substancave narkotike si burime njerëzore shumë të kufizuara për shëndetin mendor të fëmijëve.

Këto janë disa nga problemet të cilat i ka evidentuar KOMF në raportin "Karta e vlerësimit - cili është rezultati i përgjithshëm i Kosovës për kujdesin ndaj fëmijëve?"

Duke përmendur mungesën e barnave, KOMF ka veçuar medikamentin surfakant, pa të cilin foshnjat e lindura para kohe mund të vdesin, e ky medikament

nuk është përfshirë fare në listën e barnave esenciale.

Qendra korrektuese, pa edukator e vetëm me një punëtor social

Sipas raportit, Shërbimi Korrektues i Kosovës gjatë vitit 2022 ka pranuar 126 raste të fëmijëve në konflikt me ligjin, ku si vepra më dominuese ishin 24 lëndime të lehta dhe të rënda trupore, 22 vjedhje dhe vjedhje të rënda, 19 grabitje, 11 vrasje në tentativë dhe 10 dhunime, si dhe vepra të tjera.

Vendosja dhe trajtimi i rasteve të të miturve të pranuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës bëhet në Qendrën Edukuese Korrektuese dhe Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan. Sipas KOMF, kjo qendër nuk ka asnjë edukator, por vetëm një punëtor social. "Ky numër na tregon për gjendjen dhe mundësinë reale që një punëtor social të punojë dhe të ofrojë shërbime cilësore për të gjithë këta të mitur", thuhet në raport.

Gjithashtu, në këtë raport është shprehur shqetësim edhe për mungesën e një qendre korrektuese për të miturat. Sipas KOMF-it, ato vendosen në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan me të paraburgosurat dhe të dënuarat e rritura. "Në këtë qendër korrektuese nuk ka ambient të veçantë për të miturat e dënuara, të paraburgosura si dhe ato me masa edukuese korrektuese, pra vendosja e tyre bëhet në pavijone me të dënuarat dhe të paraburgosurat e moshës madhore", thuhet në raport. (REL)

Shpallet konkurs ndërkombëtar për shtatoren e Adem Jasharit në Prishtinë

PRISHTINË, 6 MARS - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar se do të shpallet konkurs ndërkombëtar për vendosjen e monumentit të Adem Jasharit dhe të familjes së tij në kryeqytet. Sipas Ramës, kjo shtatore do të jetë e karakterit modern, që pasqyron të kaluarën e tij dhe të popullit të Kosovës.

Këto komente Rama i bëri pas homazheve të shtatorja e heroit Zahir Pajaziti në shënim të "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës". "E kemi ndarë buxhetin edhe vitin e kaluar. Ishim të gatshëm ta shtyjme përpara monumentin e heroit legjendar Adem Jashari dhe të familjes së tij, por ishim në diskutim edhe me familjen e heroit legjendar për vendosjen e monumentit. Tash kemi vendosur ta shpallim një konkurs ndërkombëtar. Me

siguri do të bëhet sot. Do të kërkojmë nga arkitektë, artistë e historianë të punojnë bashkë për të prezantuar ide të ndryshme, se si do të duket monumenti i ndërlidhur me peizazh, por edhe për propozimet për lokacionet e ndryshme që mendojnë arkitektët, artistët e historianët, se ku do të ishte e përshtatshme për këtë monument", ka thënë Rama.

Ai ka deklaruar se kryeqyteti kërkon që monumenti të ketë qasje të drejtpërdrejtë për qytetarët. "Sheshi 'Adem Jashari' e ka emrin, mirëpo nuk do të thotë që domosdoshmërisht monumenti aty me qenë, për arsye se heroizmi, liria të cilën e ka sjellë heroizmi i aspektit monumental i Adem Jasharit me gjithë familjen që kanë dhënë jetën për këtë vend, do të thotë se ata janë në secilin cep të vendit tonë", ka thënë Rama.



Kryeministri i Maqedonisë së Veriut viziton Kolegjin AAB, mban ligjëratë për marrëdhëniet miqësore Kosovë - Maqedoni

PRISHTINË, 6 MARS - Kryeministri i parë shqiptar në Maqedoninë e Veriut, Talat Xhaferi, ka vizituar të mërkurën Kolegjin AAB. Ai ka mbajtur ligjëratë për studentët me temë "Marrëdhëniet miqësore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Rektori i Kolegjit AAB, Blerim Olluri, i uroi mirëseardhje Xhaferit në emër të stafit të institucionit, duke shprehur vlerësimin e lartë për kontributin dhe angazhimin e kryeministrit ndër vite për Kosovën dhe qytetarët e saj.

Kryeministri Xhaferi, përveç ligjëratës, zhvilloi takime edhe me Këshillin Drejtues të Kolegjit AAB dhe vizitoi hapësirat e shumta të institucionit. "Kolegjin AAB e kanë vizituar shumë personalitete të jetës publike dhe politike, shkrimtarë, artistë e poetë eminentë, por prezenca



juaj është e rëndësishme së veçantë dhe domethënëse e motivuese, veçanërisht për studentët tanë", u shpreh Olluri.

Kryeministri Xhaferi tha se "është kënaqësi e veçantë që gjendet para stafit dhe studentëve të Kolegjit AAB, në ambientet e

bukura, i rrethuar me intelektualët aktualë dhe të ardhshëm të vendit mik, fqinj dhe, mbi të gjitha, vëllazëror - Kosovës".

Gjatë ligjëratës ai foli për marrëdhëniet që gëzojnë ndër vite dy republikat, ajo e Kosovës

dhe e Maqedonisë së Veriut, të cilat janë trashëguar brez pas brezi me të gjitha sfidat, të përbashkëta dhe çdo proces tjetër të rëndësishëm për të dyja palët. "Bashkërisht gjenerata të tëra kanë renditur kontributet e tyre për shtetndërtim dhe ne

kemi të kaluar të përbashkët. Historia jonë është e dhimbshme dhe e hidhur për pasojat që ka lënë dhe përjetimet që i kemi pasur të gjithë. Sot, me rastin e shënimit të marsit të lavdishëm për 26-vjetorin e 'Epopesë së UÇK-së', kam pranuar ftesën të jem në këtë periudhë në Kosovë dhe kjo më këthen pas tek ato vite", ka thënë Xhaferi.

Si shenjë mirënjohje për praninë e tij, kryeministrit Xhaferi iu dhurua një pikturë nga studentja e Fakultetit të Arteve në Kolegjin AAB, Fortesa Berisha, kurse pati edhe shumë pyetje nga studentët për integrimin e dy shteteve në BE, për thellimin e raporteve, për bashkëpunimin ekonomik, kulturor dhe arsimor etj. Xhaferi, përveç ligjëratës, zhvilloi takime edhe me Këshillin Drejtues të Kolegjit AAB dhe vizitoi hapësirat e shumta të institucionit.

Java e katërt e grevës së punëtorëve teknikë të UP-së

PRISHTINË, 6 MARS - Punëtorët teknikë dhe të sigurimit fizik të Universitetit të Prishtinës dhe ata të Qendrës së Studentëve kanë hyrë në javën e katërt të grevës. Ata hynë në grevë për shkak të pagës së ulët, për të cilën thonë se po ua vështrëson jetën.

Kryetari i Sindikatës së Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka thënë për Ekonomia Online se ende nuk janë marrë për bazë

kërkesat e tyre. Madje tha se kohën e fundit nuk ka as bisedime me rektorin e UP-së. "Po hyjmë në javën e katërt. Jo që nuk po arrijmë të bisedojmë për shumën, por nuk po arrijmë as të bisedojmë. Kjo është kryeneçësi e tyre. Të gjithëve neve po na kushton, por në rend të parë rektoratit. Kjo grevë e ka një fund. Unë kam marrë një përgjithësi, sepse

këta punëtorë kanë dashur t'ia zënë derën rektorit", ka thënë Azemi.

Ai ka shtuar se asnjë ftesë zyrtare nuk kanë marrë për të biseduar. "Ne kemi mbështetje ligjore. Nëse ka nevojë edhe një vit do të rrimë kështu. Unë bëj politikë sindikale dhe ju them bëjeni këtë sepse ne e bëjmë këtë. Unë po e bëj punën time për të ofruar dialog", është shprehur Azemi.



Zyrtarët e Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim-JICA vizitojnë QKUK-në

PRISHTINË, 6 MARS - Zëvendësuesi i drejtorit të përgjithshëm të QKUK-së, Osman Hajdari, bashkë me drejtoreshën e Klinikës së Radiologjisë, Shkendije Nuza, dhe Zyrën për Donacione në QKUK/ShSKUK, ka pritur në takim zyrtarët e Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim-JICA.

Gjatë takimit me Nagata Yoshiaki, përfaqësuesi i JICA dhe Shuto Minako, këshilltare

shëndetësore, është diskutuar lidhur me mundësitë që ka QKUK-ja për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në rast nevojë për shtetasit japonezë.

Hajdari ka falënderuar përfaqësuesit e Jica për përkrahjen që kanë dhënë me pajisje mjekësore për QKUK, duke i njoftuar përfaqësuesit e Jica, se klinikat e QKUK-së, në rast nevojë, janë të gatshme të ofrojnë kujdes për të gjithë

qytetarët, përfshirë edhe ata japonezë.

Kurse drejtoresha e Klinikës së Radiologjisë, Shkendije Nuza, ka njoftuar se shërbimet radiologjike ofrohen 24-orë. Delegacioni i JICA, bashkë me zëvendësdrejtorin Hajdari, kanë vizituar Klinikën e Neurologjisë. Ata nga afër kanë parë disa nga pajisjet mjekësore që ishin dhuruar si donacion, përfshirë rezonancën magnetike.



Emërohet raportuesi për heqjen e vizave për poseduesit e pasaportave serbe në Kosovë

PRISHTINË, 6 MARS - Përfaqësuesi evropian Matjazh Nemeč u emërua raportues për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës që janë posedues të pasaportave nga Serbia. Ai e konfirmoi emërimin përmes rrjeteve sociale dhe tha se pret një vendim të shpejtë për anulimin e vizave për serbët e Kosovës që kanë pasaporta të lëshuara nga autoritetet serbe.

Qytetarët e Kosovës që kanë pasaporta të Republikës së Kosovës e gëzojnë regjimin pa viza që nga 1 janari i këtij viti. Por, nga ky vendim u përjashtuan ata qytetarë që kanë pasaporta të lëshuara nga Autoriteti Koordinues, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. Ata u përjashtuan edhe kur u hoqën vizat për qytetarët e Serbisë në dhjetor të vitit 2009.

Me vendimin për anulimin e vizave për Kosovën, qytetarët që kanë vetëm pasaporta serbe mbeten të vetmit në Ballkanin



Perëndimor që nuk gëzojnë regjim pa viza me vendet evropiane.

Në nëntor të vitit 2023 Komisioni Evropian propozoi fillimin e procedurave për përfshirjen edhe

të qytetarëve të Kosovës me pasaporta nga Serbia në liberalizimin e vizave. Qeveria e Kosovës u shpreh kundër, duke thënë se është e shqetësuar për një propozim të tillë pa

konsultime apo njoftime paraprake.

Prishtina zyrtare nuk i njeh pasaportat serbe të Autoritetit Koordinues, sepse konsideron se ato lëshohen nga një institucion

ilegal. “Njohja e këtyre dokumenteve cenon integrimin e komunitetit serb, dëmton përpjekjet tona afatgjatë [për integrimin e serbëve]”, shkroi zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, në “Facebook” më 21 nëntor.

Ai, gjithashtu, tha se pjesëtarët e komunitetit serb me pasaporta të Kosovës do të mund të lëvizin lirshëm në zonën e shteteve evropiane, të njohur si Shengen. Vendimin për heqjen ose jo të vizave e marrin Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian.

Parlamenti Evropian përfundon punën në prill, pasi institucioni hyn në fushatë parazgjedhore për zgjedhjet evropiane që do të mbahen në qershor.

Mbetet e paqartë nëse do të ketë kohë të mjaftueshme për t'i respektuar të gjitha procedurat që vendimi për këtë të merret gjatë mandatit aktual të Parlamentit Evropian.

Në muajin maj përfundojnë punimet në Onkologji



PRISHTINË, 6 MARS - Ministri i Shëndetësisë, Arben Viti, ka vizituar punimet në Klinikën e Onkologjisë. Ai ka bërë me dije se në muajin maj përfundojnë punimet që transformojnë rrënjësisht Klinikën e Onkologjisë. “Nga 45 në 95 shtretër; Ventilimi qendror, i munguar deri më tani; Ambiente komode me standarde moderne; Funkcionalitet i lartë në qasje për pacientët”, ka njoftuar ministri.

Gjithashtu, është bërë me dije se është investuar me fokus të veçantë edhe në aparatura moderne si akselerator i ri me anë të të cilit mundësohen shërbime precize dhe cilësore, është ulur lista e pritjes në zero. “1 milion e

444 mijë euro është vlera e kësaj pajisje investim. Zgjerim të Listës së Barnave Esenciale për sëmundjen e kancerit; nga 8 milionë sa ishte, tani është 13 milionë. Hap tjetër i rëndësishëm është decentralizim i terapisë tabletare tashmë në disa regjione. Sigurimi i HPV vaksinave, proces i cili tashmë ka filluar dhe po vazhdon sipas planit dhe dinamikës së punës të vajzat e klasave VI, vaksinë kjo e cila do të ndikojë në parandalimin e kancerit të qafës së mitrës si një ndër shkaktarët më të mëdhenj të vdekjeve pas kancerit të gjirit. Reforma po merr formë, klinikat tona po transformohen”, ka thënë ministri Viti.

KQZ-ja miraton katër rregullore zgjedhore

PRISHTINË, 6 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në mbledhjen e mbajtur të mërkurën, ka miratuar katër rregullore zgjedhore.

KQZ-ja ka miratuar

Rregulloren për regjistrimin dhe funksionimin e partive politike, atë për emërimin, përbërjen dhe funksionimin e Komisioneve Komunale për Zgjedhje (KKZ), Rregulloren

për krijimin, konfirmimin dhe kundërshtimin e listës së votuesve dhe Rregulloren për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre.



KMDLNj-ja: Standardet e dyfishta të drejtësisë ndaj gazetarit Lirim Mehmetaj

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 MARS - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka njoftuar se është duke e përcjell me vëmendje debati i zhvilluar në opinionin publik lidhur me çështjen e gazetarit Lirim Mehmetaj, duke njoftuar se ka pranuar kallëzim penal privat kundër L. M. nga pala e dëmtuar D. M. "Andaj, njoftojmë opinionin publik se veprimet e ndërmara në këtë çështje janë në drejtim të trajtimit të Kallëzimit penal, për të cilën Prokurori i Shtetit ka obligim ligjor të trajtoj dhe sqaroj të gjitha rrethanat të cilat pretendohen nga palët e përfshira në proceset që zhvillohen para Prokurorit të Shtetit. Megjithatë, në situatën konkrete, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, z. Zejnullah Gashi, do të analizoj veprimet e prokurorës së rastit për këtë çështje dhe do të vlerësoj nëse eventualisht ka tejkallim të kompetencave që nuk janë në përputhje me ligjin. Prokurori i Shtetit mbetet i përkushtuar për respektimin e lirisë së shprehjes dhe të drejtave të tjera të njeriut të cilat janë të garantuara me Kushtetutë dhe ligjet në fuqi", ka njoftuar Prokuroria Themelore në Prishtinë.

Lirim Mehmetaj në reagimin e tij ka theksuar: "Vetëvendosja kriminale po më akuzon për 'nxitje të përçarjes dhe mosdurimit'. 'Pushiteti kriminalo-banditesk i Albin Kurtit që e pengon prokurorinë me hap rast për Martin Berishajn e ndërhyjnë për fajdexhi qysh është rasti i vëllait të zëvendës-ministrit të drejtësisë, e nuk e dënon Glauk Konjufcën përkundër se e pranon fajësinë, paska vendos të më përndjek mua. Fatmirësisht, rastësisht mora vesh që është hapë ky rast edhe shkova vetë me marrë në Postë thirrjen, se askush s'ma ka sjellë në shtëpi e as nuk ma kishin sjellë derisa do të kalonte afati i paraqitjes. Me siguri për të krijuar ndonjë tip drame të arrestimit. Qeveria e Vetëvendosjes që s'lë kë pa e

akuzuar në bazat më të ndyta, e drektuar nga njerëz si Dejana Mihailli, pasi kanë provuar krejt çka është e mundur për të gjetur diçka për mua, e normalisht s'kanë gjetur gjë, po provojnë nëpërmjet rrugëve institucionale me bo përndjekje politike. Në rregull është, politikisht u përgjigjem edhe unë, veç kush është ai prokuror a prokurorë që i anashkalojnë gjithë sulmet, kërcënimet, fryrjet, ofendimet, shantazhet, manipulimet, keqtrajtimet, abuzimet, shpifjet, përgojimet që i bënë Lëvizja Vetëvendosje, edhe vendos të merret më mua në këtë formë", ka shkruar Mehmetaj në "Facebook". Për këtë ka reaguar Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, duke theksuar se ka pranuar me shqetësim të madh njoftimin nga gazetari i "Albanian Post", Lirim Mehmetaj, për thirrjen që i është bërë si i pandehur nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë. "Në thirrjen për paraqitje më 7 mars, Mehmetaj është ftuar si i pandehur për veprën penale 'nxitje të përçarjes dhe mosdurimit' nga Neni 141 i KPR-së. Derisa AGK është në pritje të informacioneve zyrtare, thirrja e tillë ndaj një gazetari është alarm për një shoqëri demokratike, siç pretendon të jetë Kosova. AGK-ja, do të kërkojë informacionet zyrtare dhe do ta ndjekë nga afër të enjten këtë zhvillim të pashembullt të sistemit të drejtësisë në Kosovë", është thënë në reagimin e AGK-së.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut ka reaguar ndaj ftesës që Prokuroria Themelore në Prishtinë ka bërë ndaj gazetarit Lirim Mehmetaj. "Gazetari i gazetës 'Albanian Post', Lirim Mehmetaj është ftuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë si i dyshuar për veprën penale: 'nxitje e urrejtjes...', që është i barasvlershëm me veprën penale në ish Jugosllavi që cilësohej si Propagandë Armiqësore. Me këtë ligj dënoheshin kryesisht shqiptarët dhe kundërshtarët politikë të regjimit komunist të atëhershëm. Gazetari Lirim Mehmetaj bëri



hulumtime dhe nxori materiale nga arkiva për ish-bashkëpunëtorët e regjimit jugosllav dhe serb, pasardhësit e të cilëve janë në majat apo institucionet e rëndësishme të regjimit aktual. Prokuroria u tregua shumë e shpejtë në reagim ndaj gazetarit Mehmetaj, pas denoncimit nga një person i pidentifikuar deri më tani në ndërkohë që nuk reagoi fare ndaj trajtimit publik puro racist ndaj gazetarit Mehmetaj nga një 'analist' i regjimit, ditë më parë për shkak të prejardhjes territoriale nga vjen Lirim Mehmetaj. Kjo, për KMDLNj-ë është rast tipik dhe flagrant i zbatimit të drejtësisë sipas standardeve të dyfishta dhe në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut, në përgjithësi dhe lirinë e shprehjes së mendimit, në veçanti", është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke theksuar se ky

rast është përpjekje që përmes frikësimit me pasoja ligjore të heshtet e kaluara, e vërteta dhe çdo mendim kritik. "Nëse Prokuroria e merr si pikë referuese rastin Mehmetaj si veprë penale: 'urrejtja dhe përçarja ...', atëherë gjysma e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, kabineti qeveritar dhe, së paku 8-10 analistë do të duhej të ftoheshin nga kjo Prokurori për vepra shumë më të rënda. Mjafton të përcillen debatet televizive dhe postimet në Facebook si dhe në portale të shumta pas së cilave një Pavijon i Burgut në Dubravë do të rezervohej për këto raste. Me këtë rast dhe me këtë reagim, KMDLNj kundërshton fuqishëm zbatimin e standardeve të dyfishta ndaj gazetarit Lirim Mehmetaj duke e konsideruar si përndjekje të motivuar politikisht dhe kombëtarisht për t'ia pamundësuar hulumtimin dhe

bërjen publike të së vërtetës për një të kaluar kompromituese të një pjese të regjimit aktual", thuhet në të këtë reagim. KMDLNj ka theksuar se e sheh të domosdoshëm miratimin e një Ligji të Lustracionit të Figurave Publike për t'u sqaruar e kaluara dhe për t'iu hequr mundësia që personat e komprometuar politikisht dhe kombëtarisht të bartin poste publike. "Po të bëhej ky veprim, nuk do ta kishim fare rastin Lirim Mehmetaj. Deti atëherë, mbetet e riinkarnuara nga e kaluara do të sajojnë këso raste për ta mbajtur peng të kaluarën duke e sajuar të tashmen dhe të ardhmen sipas nevojave të tyre. KMDLNj solidarizohet me Lirim Mehmetajn dhe të gjithë ata ndaj të cilëve zbatohen standardet e dyfishta", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

UP-ja trajnon zyrtarët administrativë për zbatimin e rregullores për studime të doktoratës

PRISHTINË, 6 MARS - Universiteti i Prishtinës, në fokusin e vazhdueshëm për përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe mbështetjen e shërbimit ndaj studentëve, ka mbajtur trajnimin për zbatimin e rregullores për studimet e doktoratës për zyrtarët administrativë, përgjegjës për administrimin e studimeve të doktoratës.

Qëllimi i trajnimit ishte sigurimi i njohurive dhe aftësive praktike për analizën dhe zbatimin e rregullores dhe formularëve përcjellës, gjë që synon ta



përmirësojë efikasitetin dhe transparencën e proceseve administrative për studentët në nivelin e doktoratës.

Rektori i UP-së, prof. Qerim Qerimi, ka theksuar rëndësinë e mbështetjes së studentëve dhe ofritim të shërbimeve që u mundësojnë studentëve të doktoratës një përvojë cilësore gjatë studimeve.

Po ashtu, prorektorja për akreditim, cilësi të mësimin dhe çështje të studentëve, prof. Njomza Llullaku, Gazmend Shabaj dhe Sinavere Ukshini, nga

Zyra për Çështje Akademike, kontribuan në identifikimin e pikave për përmirësimin e infrastrukturës administrative dhe teknologjisë së informacionit për shërbimin studentor.


Me përfundimin e këtij trajnimi zyrtarët e shërbimit studentor në Universitetin e Prishtinës janë pajisur me njohuri dhe aftësi të reja, duke sjellë një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së shërbimit për studentët dhe duke thelluar integritetin akademik në studimet e nivelit të doktoratës.

Ndahen 121 serra për fermerët mitrovicas

MITROVICË, 6 MARS - Komuna e Mitrovicës ka shpërndarë 121 serra për fermerët mitrovicas në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me organizatën "Islamic Relief Kosova". Nënkrjetari i komunës, Arian

Tahiri, i ka uruar fermerët përfitues, duke u thënë atyre se këto serra do t'u ndihmojnë për kultivimin e prodhimeve vendore dhe për furnizimin e tregut me kultura bimore. "109 nga këto serra kanë sipërfaqe 1 ari,

ndërkaq 12 sosh janë për 5 ari tokë. Gjatë këtij viti pritet të realizohen edhe projekte të tjera duke shpërndarë grante të ndryshme bujqësore për fermerët", thuhet në njoftimin e komunës së Mitrovicës.



Ç'është Akti i BE-së për Tregjet Digjitale dhe si i sfidon gjigantët teknologjikë?

PRISHTINË, 6 MARS - Rregullat e reja të Bashkimit Evropian do t'i rishkruajnë parimet themelore të të bërit biznes në internet dhe në telefona mobilë, duke e përmbysur mënyrën se si gjigantët teknologjikë fitojnë para dhe se si konsumatorët qasen në shërbimet që ata ofrojnë.

Akti për Tregjet Digjitale është një ndër ligjet më të rrepta në botë që merret me dominimin në treg të kompanive më të mëdha teknologjike të planetit dhe ka për synim t'ua lehtësojë njerëzve kalimin në shërbime të tjera konkurrense - siç janë platformat e medieve sociale, shfletuesit e internetit dhe dyqanet e aplikacioneve.

Krahu ekzekutiv i BE-së, Komisioni Evropian, në shtatorin e vitit 2023 caktoi 22 shërbime të kompanive të mëdha teknologjike si "roja" të shërbimeve online dhe u dha kohë atyre deri më 7 mars 2024 që të harmonizoheshin me rregullat e reja.


Kjo do të thotë që atyre do t'ju duhet t'i bëjnë aplikacionet e tyre për mesazhe ndërvepruese me ato të rivalëve dhe t'i lënë përdoruesit të vendosin se çfarë aplikacione duan të instalojnë paraprakisht në pajisjet e tyre.

Ndër këto firma janë Alphabet (pronare e Google, YouTube e Android), Amazon, Apple, Meta (pronare e Facebook, Instagram e WhatsApp), Microsoft dhe ByteDance (pronare e TikTok).

U hedhim një vështrim mënyrave se si rregullat e reja mund të ndikojnë te secili shërbim.

Reklamata

Sipas Aktit të BE-së për Tregjet Digjitale, shërbimet e cilësuar "roja" tani duhet ta marrin pëlqimin e qartë para se të gjurmohen një përdorues për qëllime reklamuese. Konsumatorët e bizneseve që përdorin shërbime të reklamave



online, të ofruara nga Amazon, Google dhe Meta, do të kenë të drejtë t'i kërkojnë të dhënat e grumbulluara në lidhje me fushatat e tyre, një resurs i vlefshëm që shpesh është mbajtur i fshehur.

Dyqanet e aplikacioneve

Apple dhe Google do të detyrohen të ofrojnë hapësirë për dyqane aplikacionesh nga palë të treta në pajisjet e tyre me sistemin operativ iOS, përkatësisht Android.

Aktualisht, përdoruesit e pajisjeve me Android mund të instalojnë aplikacione nga burime alternative, por kjo shpesh i

detyron ata t'i ndalin disa opsione të sigurisë. Apple ka paralajmëruar kundër instalimeve të tilla për shkaqe sigurie.

Ekspertët e sigurisë kanë paralajmëruar një "ortek dyqanesh alternative të aplikacioneve", sapo rregullat e reja të nisin së zbatuari, me potencial për oferta ekskluzive - duke bërë që disa lojëra dhe aplikacione të ofrohen për shkarkim vetëm përmes dyqaneve të caktuara.

Ben Wood nga firma për analiza të industrisë, CSS Insight, ka thënë se bizneset e vogla, si dhe gjigantët si Amazon dhe Microsoft, mund të përpiqen t'i joshin konsumatorët dhe zhvilluesit të dyqanet e tyre të aplikacioneve.

Aplikacionet e parazgjedhura

Sikur në rastin e dyqaneve të aplikacioneve, konsumatorët më nuk do të mund të shtyhen drejt përdorimit të aplikacioneve të tjera të parazgjedhura në pajisjet e tyre - siç është shfletuesi i internetit Safari në iPhone, apo aplikacioni për harta Google Maps në një telefon me Android. "Rojat" duhet t'u lejojnë përdoruesve të kalojnë më lehtë nga shërbimet e parazgjedhura në pajisjet e tyre - përfshirë dyqanin e aplikacioneve, shfletuesin e internetit, aplikacionin e hartave e të tjera - në alternativat e

zgjedhura nga vetë ata. Për shembull, kjo mund t'u ofrojë përdoruesve një "menyë zgjedhjeje", me një varg opsionesh, gjatë konfigurimit të pajisjes së tyre.

Tregtia online, motorët e kërkimit dhe rrjetet sociale

Shërbimeve të ndryshme, si tregut të Amazon-it, pasqyrës së përbajtjes në Facebook dhe motorit të kërkimit të Google-it, do t'u ndalohe favorizimi i shërbimeve dhe produkteve të tyre karshi alternativave kur përdoruesit i përdorin ato. Gjiganti i tregtisë online, Amazon, është përballur me hetime globale, pas akuzave se i ka favorizuar produktet e veta para atyre të shitësve të tretë që kanë përdorur platformën e tij.

Mesazhet

Sipas rregullave të reja të Aktit për Tregjet Digjitale, aplikacionet për mesazhe të shërbimeve "roja" më nuk do të jenë të izoluara nga njëri-tjetri.

BE-ja deri më tani i ka veçuar vetëm shërbimet Facebook Messenger dhe WhatsApp, që të dyja në pronësi të Meta-s. Sapo Akti të nisë së zbatuari, përdoruesit do të duhej të kenë mundësinë t'u dërgojnë mesazhe kontakteve në aplikacione të tjera - si Signal apo Telegram - nga këto platforma.

Zyrtarët janë aktualisht duke shqyrtuar nëse shërbimi iMessage i Apple-it duhet t'i shtohet listës. Një hap i tillë do të përbente një ndryshim të madh për gjigantin amerikan të teknologjisë, i cili ka dizajnuar një ekosistem të tërë produktesh - iPhone, iPad, kompjuterë Mac dhe të tjera - mbi bazën e bashkëveprimit të shkëlqyeshëm mes vete.

MFPT shpall ankandin e tretë të letrave me vlerë

PRISHTINË, 6 MARS - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 13 mars do të mbahet ankandi i tretë për vitin 2024. Në këtë ankand do të emtohen Bono Thesari me maturitet 12-mujor në shumën prej 20 milionë

eurosh. Investimi në Obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (12 muaj) dhe

është tërësisht i liruar nga tatimi.

MF-ja ka njoftuar se për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë, të kontaktohet ndonjëra nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë.



Fuqia e dëmshme e pasqyrimit



Nga: Zija VUKAJ

Meqenëse njeriu i ka kthyer veglat në armë, nga nevoja apo nga mania, nga domosdoshmëria për t'u mbrojtur apo nga etja e destruksionit, grupet e njerëzve të të njëjtit lloj (në fushën e zanatit, të profesionit apo të artit) kanë krijuar kodin deontologjik. Ne njohim si kodin e parë deontologjik betimin e Hipokratit:

“Në çastin kur po hyj në radhët e anëtarëve të profesionit mjekësor, premtoj solemnisht se jetën time do ta vë në shërbim të njerëzimit. Ndaj mësuesve do ta ruaj mirënjohjen dhe respektin e duhur. Profesionin tim do ta ushtroj me ndërgjegje e me dinjitet. Shëndeti i pacientit tim do të jetë brenga ime më e madhe. Do t'i respektoj e do t'i ruaj fshehtësitë e atij që do të më rrëfëhet. Do ta ruaj me të gjitha forcat e mia nderin e traditës fisnike të profesionit të mjekësisë. Kolegët e mi do t'i konsideroj si vëllezër të mi. Në ushtrimin e profesionit ndaj të sëmurit tek unë nuk do të ndikojë përkatësia e besimit, e nacionalitetit, e racës, e politikës, apo përkatësia klasore. Që nga fillimi do ta ruaj jetën e njeriut në mënyrë absolute. As në kushtet e kërcënimit nuk do të lejoj të keqpërdoren njohuritë e mia mjekësore, që do të ishin në kundërshtim me ligjet e njerëzimit. Këtë premtim po e jap në mënyrë solemne e të lirë,

duke u mbështetur në nderin tim personal”.

Brenda një harku të shkurtër kohor, në mjaft kanale televizive, në emisionet e lajmeve, shikuesi shqiptar ka parë dhjetëra kronika të zeza, me variacionet më të paimagjinueshme të krimeve, që monstra të caktuara njerëzore kanë kryer në frekuencën e rregullt të ekzistencës së tyre. Diku një burrë që vret gruan, diku një grua që vret burrin, diku një baba që vret nënën e dy fëmijëve, diku një dhëndër që plagos me thikë babain dhe nënën e nuses, diku një djalë që vret prindërit se nuk i kanë dhënë para, diku një emigrant që vret vëllain e një vajze, aspirante për të qenë e fejuara e tij, një vëlla që vret me qetësi vëllain dhe kunatën e vet etj., etj.

Dhe, më pas vjen rekuizita: një hanxhar me dy tehe, si i ardhur nga librat e simbologjisë së Pier Grimalit, një sëpatë e mprehtë, një pushkë model 56; një kallashnikov a shkorpiions etj. Pastaj teatri i gjëmave që kanë ndodhur: shtëpi të hapura për mort, gra e burra të vrenjtur e me pamje pikëlluese, vargje njerëzish të zymtë nëpër ceremoni mortore nëpër monopate fshatrash apo lagjesh. Dhe gjithmonë persona që ikin në drejtime të paditura dhe lot të pafajshëm nënash dhe foshnjash. Gjithë ky një realitet shqiptar! A ndodhin këto? Ndodhin. A duhet të kërkohen dhe të jepen me kaq zell nëpër kanale televizive? A kanë ndikim tek shikuesit këto pamje? Dhe

cili është efekti i tyre? Si ndikojnë pamjet makabre, që ne i shohim përnatë pa ndalesë, në psikikën e njerëzve të veçantë.

Thuhej në Greqinë e lashtë: “Nuk duhet të shkojnë në teatër gratë athinase për të parë ‘Medean’ e Euripidit, sepse ka mundësi që sapo të kthehen në shtëpi, të vrasin burrat e tyre”. Kjo thënie mbështet forcën që skena ka mbi njeriun. Tani ne e kemi ‘teatrin’ nëpër shtëpitë tona. Një nga sekretet e pushtetit të medias është etja për të imituar çdo gjë që vjen nga ajo botë magjike që na shfaqet nga ekrani. Aty është fuqia e magjepsjes, aty është dëshira e imitimit; aty është justifikimi i çdo devijimi që bëhet në jetën tonë, me kusht që t'u ngajë devijimeve të personazheve të skenës.

Të rinjtë janë të etur t'i ngajnë çdo psikopati dhe individit me shkallë të llahtarshme perversiteti që shohin nëpër ekrane. Kemi parë sharlatanë, barbonë, pseudokëngëtarë, pseudoartistë, që janë përzënë nga bodrumet e metropoleve të Evropës, kanë vuajtur edhe dënime si delinkuentë fare ordererë dhe shfaqen para publikut tonë si përfaqësues rrymash muzikore moderne, kur nuk kanë pasur rastin të njohin as pentagramin, as alfabetin e gjuhës së tyre amtare. Dhe të rinjtë të sotëm që i shohin nga ekrani, u duken heronj dhe vdesin t'u ngajnë. Është i paparashikueshëm numri i njerëzve që shohin një kronikë

në TV. Është edhe më i paparashikueshëm dhe i panjohur niveli kulturor i tyre. Është e panjohur dhe e frikshme psikika dhe gjendja e tyre mendore. Për një pjesë dhënia e një kronike të zezë në mënyrë aq të detajuar, mund të jetë shumë e mirë. Mund të nxisë mendime dhe reagime pozitive. Mund të shërbejë për të demonstruar gjërat që nuk duhen bërë.

Ndërsa për një pjesë tjetër, ndoshta edhe më të madhe, këto kronika bëhen etje imitimesh, përvetësim teknikash krimi, plotësime etjesh sadiste të fjetura në subkoshienat e individëve që me pak nxitje i vënë në lëvizje. Turma është e paparashikueshme. Ka ligjet e veta. I mungon gjithmonë logjika, i mungon meditimti, nuk mendohet kurrë, është një kafshë e stërmadhe dhe e frikshme, vepron me një gjysmë komande, i mungon hapësira e dëshiruar dhe manipulimi ndaj saj është i lehtë. Mjerisht, gjërat e pasakta, informacionet e shtrembra, sjelljet brutale e devijante, balta e hedhur ndaj gjërave të rregullta, ofendimet deri në linçim, folkshkenca e sidomos perversitetet e koleksionuara dhe të përqendruara në “shtëpinë më të fisme” – “Big Brother”, mbushur plot VIP-a janë pjesa më e pëlqyer, më e kërkuar, më spektakolare, pas së cilës turma çmendet, dalldiset, braktis qytetin me gjithë rrugët e tij dhe ndryhet për orë të tëra e galvanizuar prej kënaqësisë.

Në vitin 1997 u vranë shumë njerëz. Një pjesë e madhe u vra vetëm sepse u krijua mundësia që çdo njeri të pajisej me pushkë. Individit, kur e pa veten me armë në dorë, nuk arsyetoi më gjatë dhe e përdori. E përdori për të lëshuar krisma, për të trembur dikë, për t'u gëzuar për rastet e jetës, për lindjen e fëmijës, për martesë, për t'u dukur më trim para të tjerëve, për t'i mbushur mendjen vetes se është më i sigurt. Madje, shpesh e përdori edhe kundër vetes. Për këtë arsye dhe për shumë arsye të tjera, që kanë të bëjnë me njeriun, me larminë e tipave njerëzorë, me format e panumërta me të cilat individët reagojnë para të njëjtit realitet, duhet kërkuar e vendosur edhe njëherë një kod deontologjik për të bërë të mundur administrimin e kronikave.

Kushdo që vendos ta mbushë eterin mediatic apo televiziv me ato pamje, duhet të imagjinojë fytyrat e individëve që do t'i ndjekin ato. Thjesht t'i imagjinojë dhe të arsyetojë, sepse nuk është e mundur as e nevojshme të njihen njerëzit një nga një për të njohur gjithë popullin. Dhe popullin tonë duhet ta njohim ne, me perceptimet dhe intelektin tonë. Nuk duhet të kërkojmë ndihmën e të huajve për të njohur shqiptarin dhe të aplikojmë ligje norvegjeze, anglosaksone, franceze etj. mbi njeriun shqiptar dhe pastaj të çuditemi si nuk e kryen shkalla funksionin e litarit ...

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Sadiku në çerekfinale, dy fitore larg Olimpiadës

PRISHTINË, 6 MARS - Donjeta Sadiku është kualifikuar në çerekfinale të turneut kualifikues botëror të boksit për Lojërat Olimpikë "Paris

2024" i cili po mbahet në Busto Arsizio të Italisë. Bokserja e Kosovës mundi greken Christina Linardatou, kategoria -60 kg. Tash

Donjetës i duhen edhe dy fitore për ta siguruar "vizën" për Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Të dielën ka garuar Bashkim Bajoku (-51

kg), i cili pësoi humbje në rrethin e parë. Të enjten në ring ngjitet edhe Shpëtim Bajoku (-63.5 kg).



Prishtina dhe Drita kualifikohen në gjysmëfinale të Kupës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 6 mars - FC Prishtina dhe Drita kanë regjistruar një sukses të mërkurën. Ato janë kualifikuar në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në Futboll, pasi kanë mposhtur Trepçën '89 dhe Dukagjinin. Kryeqytetasit kanë shkëlqyer në ndeshjen e zhvilluar në Lipjan kundër Trepçës '89, pasi kanë fituar me rezultat bindës 5-1. Kryeqytetasit ishin dominues në pjesën e parë dhe realizuan katër gola. Pas vetëm nëntë minutave lojë, Leotrim Kryeziu nga afërsia realizoi për 1-0, ndërsa Ardian Muja (25') shënoi një gol të bukur për rezultat 2-0.

Në minutën e 40 ishte Mërgim Pefqeli i cili shënoi nga pika e bardhë për 3-0, ndërsa në minutën e fundit të pjesës së parë Hasan Hyseni realizoi një supergol për rezultat 4-0. Mysafirët shënuan në minutën e

72-të për rezultat 4-1, ndërsa Iqball Jashari shënoi në minutën e 82-të për rezultat final 5-1.

Pas Prishtinës në gjysmëfinale të Kupës është kualifikuar edhe skuadra e Dritës. Gjilanasit janë djersitur mirë për të arritur deri te ky sukses, pasi e mposhtën Dukagjinin e Klinës vetëm pas ekzekutimit të penalltive me rezultat 3-4. Koha e rregullt dhe vazhdimet përfunduan pa gola 0-0. Drita shënoi katër penallti dhe humbi një, kurse Dukagjini shënoi tri herë dhe dështoi në dy të tjera.

Çiftet gjysmëfinale do të kompletohen sot (e enjte) kur do të zhvillohen edhe dy ndeshjet e tjera çerekfinale. Vëmendja do të jetë në përballjen e skuadrave elitare, Malishevës dhe Ballkanit. Të dyja këto klube do ta synojnë kualifikimin në fazën e ardhshme të Kupës dhe normalisht se pritet një derbi i fortë duke e parë formën e mirë të Malishevës në



ndeshjet e fundit në Superligë, por edhe kualitetin e Ballkanit në

anën tjetër. Në ndeshjen tjetër Vjosa do të përballet me skuadrën

e Suharekës. Të dyja këto ndeshje zhvillohen nga ora 13:00.

Liga Unike, fitojnë Bashkimi, Prishtina dhe Tirana



PRIZREN, 6 MARS - Bashkimi ka vazhduar me fitore në Liga Unike Femrat, duke regjistruar fitoren e shtatë në po aq ndeshje të zhvilluara, njëkohësisht skuadra e vetme pa humbje. Prizrenaset në sfidën e fundit kanë mundur Partizanin me rezultat 76:44 (16:14, 18:7, 18:8, 24:15). Vetëm çereku i parë ishte i baraspeshuar, më pas kampionet e Kosovës treguan fuqinë, duke ngritur epërsinë minutë pas minute dhe për të triumfuar në fund 76:44. Bindshëm më e mira te vendaset

ishte Aulona Muhadri me 19 pikë, 18 kërcime dhe gjashtë asistime, kurse te mysafiret Sophia Jacobsson kishte 12 pikë. Derisa Bashkimi ka shtatë fitore në shtatë ndeshje, Partizani ka dy fitore e pesë humbje. Prishtina po vazhdon me formë të lartë në Liga Unike Femrat, ku kësaj radhe shënoi fitore ndaj Penzës me rezultat 73:79 (22:25, 15:20, 19:17, 17:17). Më e mira te Penza ishte Saranda Daci me 20 pikë e 11 kërcime, kurse te Prishtina më e mira ishte Asiana Johnson

me 30 pikë, tetë kërcime dhe tetë asistime. Prishtinaset kanë gjashtë fitore dhe vetëm një humbje, kurse ajo pejane ka dy fitore e pesë humbje. Tirana shënoi fitore të rëndësishme ndaj Flamurtarit me shifrat 62:59 (20:12, 11:21, 19:15, 12:11). Tashmë tiranaset kanë tri fitore dhe katër humbje, kurse ajo vlonjate dy fitore e pesë humbje. Më e mira te vendaset ishte Enisa Qosja me 18 pikë, katër kërcime dhe tri asistime, ndërsa te mysafiret më e mira ishte Asia Henderson me 17 pikë dhe 22 kërcime.

Gjilani paraqet Hotin dhe Sahitajn

GJILAN, 6 MARS - Sport Club Gjilani ka transferuar dy futbollistë. Bëhet fjalë për Albin Hotin dhe Leunit Sahitaj. Hoti 22-vjeçar në klubin e Gjilanit vjen nga futbolli zviceran pas një të kaluarë te klubet FC Mutschellen, FC Winterthur & Grasshopper Club Zurich. "Hoti është futbollist që luan në

pozicionet e mesfushës, ndërkohë që afrohet për t'i ndihmuar ekipit në objektivat që janë për t'u arritur", thuhet në njoftimin e Gjilanit. Transferimi tjetër është futbollisti Leunit Sahitaj. 22-vjeçari i lindur dhe zhvilluar në Zvicër është produkt i akademisë së njohur

Grasshopper Club Zurich, ndërkohë që debutimin si lojtar profesionist e ka bërë tek ekipi tjetër helvet FC Schaffhausen. "Sahitaj luan në pozitën e mesfushorit ofensivë dhe vjen t'i ndihmojë ekipit në objektivat që janë vënë para", thuhet në njoftimin e SC Gjilani.



Haalandi 'tremb' Cityn, mund të largohet në verë për 200 milionë euro

MANCHESTER, 6 MARS - "Jam i lumtur te Manchester City, por kurrë nuk i dihet se çfarë do të sjellë e ardhmja". Fjalët e Erling Haaland duket si kabanë e vërtetë alarmi te Manchester City. Në Angli tashmë kanë filluar të fantazojnë për manovra të

mundshme në të ardhmen. Pep Guardiola nuk ndalet së përkëdheluri, por kujdes verën e ardhshme: 23-vjeçari nga Leeds ka një klauzolë për t'u çliruar nga "Qytetarët". Në moshën 23-vjeçare ai tashmë ka fituar një Ligë të Kampionëve dhe është në

mesin e elitës së futbollit. Shumë e konsiderojnë atë një robot të vërtetë. Norvegjezi ndoshta do të mendojë për këtë më vonë, me Real Madridin, i cili kurrë nuk ka pushuar së vëzhguari. Është një dëshirë e Florentino Perezit, por marrja e Mbappes

mund t'i ketë mbyllur derën në "Bernabeu". Në qershor 2024, ish-lojtari i Borussia Dortmundit mund të çlirohet nga Manchester City me pagesën e 200 milionë eurove. Kështu thuhet në klauzolën e fiksuar në kontratën e hartuar dy vjet më parë me "qytetarët".



CAS ul dënimin, Halep mund të rikthehet të luajë javën tjetër

LOZANË, 6 MARS - CAS (Këshilli i Arbitrazhit Sportiv) në Lozanë ka shprehur opinionin e tij për rastin e ish-numrit një të botës në tenis, rumunes Simona Halep, duke vendosur uljen e shkualifikimit nga 4 vjet në 9 muaj. Duke pasur parasysh se pezullimi hyri në fuqi në tetor 2022, Halep ka më shumë se një vit që nuk luan, për pasojë ajo mund të rikthehet në fushë menjëherë në javën e ardhshme. "Besoj se e vërteta doli në shesh. Ka qenë një diskutim i gjatë, mund të them se pata rastin të paraqes mbrojtjen time", ka thënë Halep pas publikimit të vendimit nga CAS. Tenistja 32-vjeçare, fituese e dy grand slameve në karrierë, kishte apeluar dënimin e saj katërvjeçar, e akuzuar për dy shkelje të ndryshme të rregulloreve antidoping. Agjencia Ndërkombëtare e Integritetit të Tenisit kishte njoftuar se Halep do



të duhej ta vuante dënimin prej katër vjetësh. Faktet datojnë që nga US Open 2022, kur rumunja rezultoi pozitive për një nga substancat e ndaluara nga rregullorja: Roxadustat. Gjykata e pavarur, pavarësisht se kishte mbështetur tezën e Halep se ishte një suplement i kontaminuar,

vendosi se sasia e substancës së gëlltitur nuk mund ta kishte përcaktuar përqendrimin e Roxadustat të gjetur në kampionin pozitiv. Ndryshe ishte gjykimi i CAS-it, i cili pranoi tezën e hedhur nga Halep për kontaminimin e suplementeve ushqimore të marra.

Bostoni ndalet në sekondën e fundit, Phoenixi mposhti kampionët e Denverit

CLEVELAND, 6 MARS - Kampionët e Denverit u mundën me rezultat 117-107 nga Phoenixi pas kohës shtesë. Ndashje me rivalitet deri në fund. Për miqtë u dalluan Durant me 35 pikë e Allen me 28 pikë. Murray e Jokiqi realizuan 53 pikë së bashku për Denverin, por që s'mjaftuan për të fituar. Fitore jashtë fushës edhe për Indianan, që mposhti me rezultat 137-120 Dallasin. Plot 9 lojtarë të Indianas realizuan mbi 10 pikë, duke e bërë kolektivitetin armën kryesore. Luka Doniqiqi realizoi një "triple



double" për teksanët (39 pikë, 10 rebounde, 11 asistime), por që mbetën për statistikë. Miami, falë 26 pikëve të Butlerit, mundi me rezolutat 118-110 Detroitin, duke qenë në zonën "play-off" në Lindje. Befason Brooklyni, që mundi me rezultat 112-107 Philadelphiaan, sfidë ku u dalluan

Schroder e Smith, me nga 20 pikë secili. Ndalet skuadra e Bostonit, që u mund me rezultat 105-104 nga Cleveandi në sekondat e fundit. Për vendasit u dallua Wade me 23 pikë, duke i bërë të pavlefshme 26 pikët e Tatumit për Celticsin, që pavarësisht humbjes, mbron kreun në Lindje.

REZULTATET

Charlotte - Orlando	89-101
Brooklyn - Philadelphia	112-107
Cleveland - Boston	105-104
Miami - Detroit	118-110
New York - Atlanta	100-116
Toronto - New Orleans	98-139
Houston - San Antonio	114-101
Dallas - Indiana	120-137
Denver - Phoenix	107-117

Mbappe: Dua të luaj dhe të bëj më të mirën në Ligën e Kampionëve

Skuadra e Paris Saint-Germainit pa ndonjë problem ka kaluar në fazën çerekfinale të Ligës së Kampionëve, pasi e ka mposhtur

Real Sociedadin me rezultat të përgjithshëm 4-0. Realizuesi i dy golave, Kylian Mbappe, ka thënë se dëshira e tij është të luajë dhe të

japë më të mirën në Ligën e Kampionëve. "Unë gjithmonë dua të luaj dhe të bëj më të mirën time në Ligën e Kampionëve, thjesht të

bëj më të mirën time", u thënë Mbappe. "Luis Enrique? Gjithçka është shumë mirë me të. Marrëdhënie e shkëlqyer, pa

probleme. Njerëzit mund të mendojnë ndryshe për të por, me të vërtetë, gjithçka është shumë mirë", ka deklaruar Mbappe.

SHKURT

Bellinghami suspendohet dy ndeshje për fyerjet që ia bëri gjyqtarit

Jude Bellingham është suspenduar me dy ndeshje në La Liga. Vendimi është marrë të mërkurën pas situatës së krijuar në fund të ndeshjes në mes të Valencias dhe Real Madridit. Lajmin e ka dhënë gazetari sportiv italian Fabrizio Romano.

Ky vendim lidhet me reagimin e yllit anglez kur nuk iu pranua goli në minutat shtesë pasi gjyqtari e kreu lojën derisa Brahim Diaz po harkonte në drejtim të tij. Ish-futbollisti i Borussia Dortmundit e fyeu gjyqtarin, duke i bërë titur atij dhe duke protestuar për golin që ia anuloi. Ky vendim i gjyqtarit u konsiderua skandaloz pas lojës.

Sarri: Ndashjen e parë mund ta fitonim me rezultat më të thellë

Trajneri i Lazios, Maurizio Sarri, pas humbjes nga Bayern Muncheni (3-0) dhe eliminimit nga Liga e Kampionëve, ka thënë se ky dështim erdhi si pasojë e ndeshjes së parë ku klubi i tij është dashur të fitojë me rezultat më të thellë. "Pengu më i madh është se në ndeshjen e parë mund të fitonim me një rezultat më të thellë. Ndërsa këtu në Munchen, më vjen keq për golin e dytë të pësuar nga një goditje këndi e paqenë, ai gol na preu shpresat. Gjithsesi, besoj se bilanci në këtë edicion të Ligës së Kampionëve ka qenë pozitiv. Kemi fituar më shumë ndeshje sesa kemi humbur", u shpreh Sarri.

Tuchel: Ëndërrojmë ta fitojmë Ligën e Kampionëve

Bayern Munchen arriti kualifikimin në çerekfinale teksa triumfoi 3-0 në duelin e kthimit ndaj Lazios. Thomas Tuchel pas ndeshjes u shfaq i lumtur, teksa pranoi se ai dhe djemtë e tij ëndërrojnë fitimin e Ligës së Kampionëve. "Kishim pritshmëri të mëdha, donim të kualifikoheshim me çdo kusht në çerekfinale. Objektivi i parë ishte të shënonim gola. Nuk e humbëm kurrë toruan dhe as përqendrimin. Fitimi i Championsit? Të gjithë skuadrat që mbërrijnë në çerekfinale ëndërrojnë. Klubet, tifozët, gjithashtu edhe unë...", ka deklaruar Tuchel.

Ancelotti akuzohet për mashtrim, rrezikon të dënohet me burg

Prokurorët e shtetit spanjoll kanë akuzuar trajnerin e Real Madridit, Carlo Ancelotti, për mashtrim të dyshuar tatimor, duke pretenduar se ai ka fshehur një pjesë të të ardhurave të tij gjatë periudhës 2014-2015 kur ishte trajner i Realit. Prokurorët thanë në një deklaratë të mërkurën se tekniku po akuzohet për dy llogari të mashtrimit tatimor që do të dënohen me katër vjet e nëntë muaj burg. Dysohet se italianin ka fshehur një milion euro gjatë kohës 2014-2015. Prokurorët pretendojnë se gjatë asaj periudhe italianin ka deklaruar vetëm të ardhurat që ka marrë nga Real Madridi dhe nuk ka deklaruar të ardhura nga të drejtat e imazhit. 64-vjeçari Ancelotti ishte trajner i Realit nga periudha 2013-2015 përpara se t'i bashkohej klubit në vitin 2021.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

